



KLUBI I PRODHUESVE TË KOSOVËS  
KOSOVO MANUFACTURING CLUB

**Institucioni:** Klubi i Prodhuesve të Kosovës

**Titulli i vendit të punës:** Praktikant - PR dhe Komunikim

**Orari i punës:** 40 orë në javë (orar të plotë)

**Kohëzgjatja e Kontratës:** Me kohë të caktuar, me mundësi vazhdimi

---

## Praktikant PR dhe Komunikim

---

### Përshkrimi i Punës

Klubi i Prodhuesve të Kosovës është organizatë e cila ka për qëllim zhvillimin dhe mbrojtjen e sektorit të prodhimit, bashkëpunimin me institucionet shtetërore dhe private me qëllim fuqizimin dhe promovimin e prodhimeve Made in Kosova, si dhe vetëdijesimin e qytetarëve për rolin pozitiv që konsumi i prodhimeve vendore luan në zhvillimin ekonomik të vendit.

Misioni ynë është të mundësojmë rrjetëzimin e anëtarëve, të ndihmojmë në motivimin dhe bashkëpunimin e tyre me njëri tjetrin dhe me palët e treta, të ndërtojmë urat e bashkëpunimit me institucionet shtetërore për fuqizimin dhe promovimin e prodhimeve vendore si dhe të vetëdijësojmë qytetarët për kualitetin e prodhimeve vendore.

### Detyrat kryesore:

Detyrat / përgjegjësitë e mëposhtme janë indikative dhe mund të modifikohen sipas nevojave të projekteve:

- Mbështet përgatitjen, zbatimin dhe përpunimin e konferencave dhe tryezave në kuadër të aktiviteteve të Klubit;
- Detyrat e menaxhimit të ngjarjeve (planifikimi i ngjarjeve, dokumentacioni i ngjarjeve, koordinimi dhe ekzekutimi i aranzhimeve logjistike para dhe gjatë eventit.);
- Sigurimi i mbështetjes administrative dhe organizative, siç është përkthimi dhe përgatitja / dokumentimi i takimeve;
- Ofron mbështetje në përgatitjen dhe shkrimin e raporteve të shkurtra pas konferencave apo tryezave në kuadër të aktiviteteve;
- Ndërmarrë aktivitete në fushën e komunikimit dhe të PR-it (website, dokumentacioni i fotografive, media sociale dhe komunikim të brendshëm);
- Ofron mbështetje në përditësimin e faqes së internetit dhe krijon përmbajtje për mediat sociale me të gjitha aktivitetet e projektit;
- Mbështetje e përgjithshme administrative;

### **Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar**

- Studentët e Universitetit (shkalla akademike do të konsiderohet si një aset), mundësisht në fusha të ngjashme si Komunikim, Marketing, Shkenca Sociale ose ndonjë fushë tjetër relevante;
- Shkathtësi të shkëlqyera në ekip dhe aftësi komunikimi;
- Shkathtësi të shkëlqyera të gjuhës shqipe dhe gjuhës angleze;
- Përvojë e punës me ose në fushën e komunikimit dhe / ose PR / Menaxhim Eventesh
- Vëmendja ndaj detajeve dhe saktësisë është e domosdoshme, për të mbështetur kolegë të ndryshëm dhe për të përmbushur afatet e ngushta;
- Njohuri me përvojë të Microsoft Office
- Aftësi në Adobe Illustrator dhe / ose Photoshop
- Të jetë në gjendje të krijojë marrëdhënie të mira dhe të vëmendshme pune me të gjithë stafin në organizatë duke treguar respekt për rolet dhe përgjegjësitë e tyre;
- Të jetë tregojë vullnet për të qenë fleksibël dhe i përgatitur për të kontribuar në detyra të tjera sipas nevojës;

**Vendi:**

- Zyra është e vendosur në Prishtinë.

**Kohëzgjatja:**

- Praktikanti duhet të fillojë sa më shpejt që të jetë e mundur. Praktika ofrohet me një kohëzgjatje të negociueshme prej 2-4 muajsh.

**Si të aplikoni**

Dërgo vetëm dokumentet e mëposhtme në [info@klubiprodhuesve.org](mailto:info@klubiprodhuesve.org)

- CV Europass
- Letër Motivimi
- Subjekti i emailit: Praktika\_Komunikim/PR\_KPK

Aplikacionet që nuk i plotësojnë kriteret nuk do të merren parasysh!